



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Kuvendi i Kryeqytetit  
Skupstina Glavnog Grada -Municipality of Prishtina



## E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 22.03.2023, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Arton Braimi, Elmire Nikçi - Rexha, Nenad Miladinovic, Oktay Kurtesh, Trieria Kasumi - Berisha, Adnan Ajeti, Kimeta Shok.

Mungoi: Faton Marrolli.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit të Kryeqytetit, Klaudia Mula, koordinatore për komunitete në ZKKK, Edona Feta, Srecko Bogajcevic, zyrtar nga UNMIK-u Arianita Beqa- Rraci, zyrtare nga UNMIK-u, Fisnik Dida, zyrtar nga OSCE, Diellza Azemi, zyrtare nga OSCE.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e komitetit me këtë

## R E N D TË D I TË S:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Ftesë për kryesuesin e Kuvendit të Komunës z. Fehmi Kupina (koordinimi i punës dhe rishikimi i rregullores së Komunës);
3. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike z. Ilirik Musliu;
4. Përmirësimi i bashkëpunimit në mes të ZKKK-së dhe Komitetit për Komunitete;
5. Raporti i ZKKK-së, për muajin Shkurt 2023;
6. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre;
7. Të ndryshme.

## Pika e parë

**Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e komitetit.**

## Pika e dytë

**Ftesë për kryesuesin e Kuvendit të Komunës z. Fehmi Kupina (koordinimi i punës dhe rishikimi i rregullores së Komunës).**

**Mirsada Behluli**, tha se pa e zgjatur më tepër fjalën ia jap kryesuesit të Kuvendit të Komunës z. Fehmi Kupina që të na njoftoj lidhur me punën e Kuvendit, duke iu referuar temave që kanë të bëjnë me interesat e komuniteteve jo shumicë.

**Fehmi Kupina**, duke iu drejtuar të pranishmëve tha se siç e dini ne në Kuvend nuk e kemi asnjë përfaqësues të komuniteteve jo shumicë, mirëpo unë si kryesues së bashku me të gjithë kolegët e mi dhe kryetarin e Komunës jemi të hapur për të gjitha komunitetet. Pra unë sot jam këtu që t'i dëgjoj hallet e juaja dhe nga pozita ku jam të shoh se çka mundem me bërë krejt për komunitetet.

**Mirsada Behluli**, duke iu falënderuar kryesuesit për fjalimin tha se në emër të gjitha komuniteteve, serbë, goran, rom, ashkali, turk, kanë paraqitur dëshirën që të kenë zyrat e veta me arsyetimin që aty të mbahen takimet dhe marrëveshjet lidhur me zgjidhjen e problemeve, me mbajtur aktivitete të ndryshme siç janë ato kulturore, të mësimit, kurse të ndryshme si dhe të gjitha aktivitetet tjera për të cilat kanë nevojë komunitetet.

Ajo në vazhdim tha se komunitetet jo shumicë të Komunës së Prishtinës kërkojnë që të respektohet Rregullorja për punësimin e komuniteteve jo shumicë në institucionet publike prej ku janë të përfaqësuar prej 10%, si në nivelin qendoror ashtu edhe në atë lokal.

Ajo mes tjerash tha se kisha me e lutur kryesuesin që të ju bëjë vërejtje drejtoreve të drejtorive të kenë obligim që t'i përgjigjen ftesës së Komitetit për Komunitete.

**Fehmi Kupina**, duke iu drejtuar të pranishmëve tha se sa për informatën e juaj ne jemi disa grupe siç e dini në Kuvend, edhe asnjë grup deri tash nuk ka një zyre, dhe ne jemi në dijeni që është nevoja që edhe ju të keni një zyre. Mirëpo tanë unë prej pozicionit që kam mundem vetëm me ju premtuar se do të angazhohem të konsultohem me kryetarin që në të ardhmen të ju sigurohet një zyre.

Ndërsa sa i përket mbeturinave që dëgjova ju e dini që ditëve të fundit tash jo vetëm ju por të gjithë ne kemi pasur problem çështjen e mbeturinave, me shpresë se do të tejkalohet shumë shpejt kjo dhe të mos kemi probleme të tilla çfarë na kanë përcjellë deri sot.

**Nenad Miladinovic**, tha se sa i përket plehrave ilegale ku atë problem e kemi të gjithë, mund të ju them se në pjesën ku un jetoj në kohën e fundit vërtet është bërë e pa mundur të jetohet ashtu që Bërnica e Poshtme, është shndërruar në deponi të mbeturinave pra e dini ajo pjesa e epërmë e dini shumë mirë pasi që së bashku jetojmë në atë pjesë.

Prandaj kisha bërë lutje për një apel pasi që nuk është hera e parë që bëjmë kërkesa dhe lutje, se edhe më herët kemi pasur kësi problemesh por është zgjidhur problemi disi.

Faqe 2 nga 5

Ai mes tjerash ceki edhe çështjen e papunësisë ku këtë problem e kanë të gjitha komunitetet, por unë isha fokusuar tek komuniteti serb. Sa i përket komunitetit serb në Komunën e Prishtinës ka më së paku të punësuar po mendoj nga territori i Prishtinës mos të keqkuptohemi. Të njëjtë problemesh ka pasur edhe më herët por ka pasur mirëkuptim dhe ka pasur të punësuar sipas kontratës, ndërsa sot gjegjësisht që 1 vit e gjysmë pra me ardhjen e qeverisjes së re ne nuk kemi asnë të punësuar të komunitetit serb.

**Fehmi Kupina**, duke u ndërlidhur në diskutimin e z. Miladinovic tha se sa i përket mbeturinave është e vërtetë ajo se çka e thoni. Ai në vazhdim tha se po sa të dal prej këtu kam me u angazhuar dhe do të kryej punën e cila më takon mua.

Ndërsa sa i përket punësimeve së pari kisha me e pyetur z. Miladinovic se a ka ndonjëri që ka konkurruar dhe iu është mohuar e drejta, prandaj provoni konkurreni e nëse do t'i mohohet e drejta atëherë unë do të jap përgjigje.

Kurse sa i përket kontratave mbi vepër meqë nuk jam kompetent për të mirëpo nëse i bëhet e padrejta secilit prej juve këtu unë do të jem zëri i juaj.

#### Pika e tretë

#### Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike z. Ilirik Musliu

**Kryesuesja**, tha se kjo pikë e rendit të ditës mbetet për diskutim në njërin prej takimeve të ardhshme të komitetit.

#### Pika e katërt

#### Përmirësimi i bashkëpunimit në mes të ZKKK-së dhe Komitetit për Komunitete

**Mirsada Behluli**, tha se sa për mendimin tim bashkëpunimi në mes të ZKKK-së dhe Komitetit për Komunitete ka qenë i kënaqshëm dhe i mirë. Ajo mes tjerash tha se po ashtu në kohë të duhur me anë të emailit na kanë informuar lidhur me shpalljen e konkurseve, lajmërimi Ministrisë për Komunitete dhe kthim. Kanë ndihmuar rrëth pakove higjenike, për dru zjarri etj. na kanë njoftuar me punën e ZKKK-së, raportet mujore, vjetore të ZKKK-së etj, prandaj dua të falënderoj znj. Klaudia për bashkëpunimin korrekt.

**Nenad Miladinovic**, tha se sa i përket bashkëpunimit të ZKKK-së me Komitetin për Komunitete, dhe punës së mirë të komitetit mund të ju them se bashkëpunimi në mes te ZKKK-së dhe Komitetit për Komunitete është i domosdoshëm.

Ai në vazhdim tha se meqë këtu kemi njerëzit të cilët dëshmojnë për punën që ka bërë komiteti tetë vitet e fundit ku ne atë kohë kemi qenë Komiteti më i mirë në territorin e Kosovës, si dhe kemi qenë shembull për të gjitha komitetet e komunave të tjera.

Ai mes tjerash tha se kohëve të fundit nuk jam i kënaqur me bashkëpunimin e ZKKK-së dhe komitetit, mirëpo kur është në pyetje bashkëpunimi me punëtorët e ZKKK-së, përveç se jam shumë i kënaqur me punën e znj. Klaudia e cila është për çdo lëvdatë.

**Klaudia Mula**, duke iu drejtuar të pranishmëve tha se sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, ju falënderoj shumë sepse është shumë me rëndësi që të diskutohet bashkëpunimi i ZKKK-së dhe Komitetit për Komunitete.

Ajo në vazhdim tha se ne kemi një referat të cilin mundohemi me e kryer me shumë përgjegjësi duke e respektuar të drejtën e secilit komunitet dhe secilën palë që paraqitet në zyrën tonë qoftë me ankesë apo kërkesë.

Gjithashtu i kemi marr parasysh të gjitha kërkesat e juaja dhe i kemi dërguar nëpër drejtori. Ajo njëherit falënderoi edhe parafolësit për fjalët miradije që u than për të pér të gjitha këto vite.

#### Pika e pestë

##### Raporti i ZKKK-së për muajin shkurt 2023

**Klaudia Mula**, sa i përket Raportit të ZKKK-së, tha se si çështje kryesore gjatë të këtij viti kanë qenë ndërmarrja e aktiviteteve konkrete për zbatimin e Planit vjetor të punës dhe Planit lokal të veprimit, në fokus ka pasur realizimin e projekteve të parapara si dhe shqyrtimin e kërkesave për riintegrin dhe integrimin e të huajve.

**Pas disa informatash dhe sqarimesh nga znj. Mula njëzëri u miratua Raporti i ZKKK-së për muajin shkurt 2023.**

#### Pika e gjashtë

**Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre**

**Nenad Miladinoviqi**, tha se sa i përket gjendjes së sigurisë nuk kemi probleme, përvèç se patëm problem me ato dy vjedhje që ndodhën në dy shtëpi ku në njëren shtëpi janë marr të holla në vlerë prej 2 mijë e diçka euro dhe ari, kurse në shtëpinë tjetër janë marr disa gjëra materiale. Policia ka qenë dhe e ka kryer punën e vet, po ashtu edhe forenzika ka kryer punën e vet.

Mirëpo problemi më i madh janë mbeturinat.

**Kimeta Shok**, tha se sa i përket gjendjes së sigurisë po ashtu nuk kemi probleme, por problemi më i madh është deponia e mbeturinave dhe qentë endacak.

#### Pika e shtatë

##### Të ndryshme

**Klaudia Mula**, tha se meqë me datën 8 prill është Dita ndërkombëtare e romëve, e pyes z. Adnan se a keni paraqitur ndonjë kërkesë se si do ta manifestoni këtë ditë, apo keni ndonjë plan lidhur me këtë, prandaj ju sugjeroj se çfarëdo përkrahje që ju duhet mundeni të paraqiteni tek ne në zyre.

**Adnan Ajeti**, tha se e kemi bërë njëfarë plani vetëm se ka mbetur me shikuar se ku po e bëjmë e pastaj ju lajmërohem.

**Mirsada Behluli**, tha se kam përpiluar kërkesën për lejimin e mjeteve për Ditën ndërkombëtare të boshnjakëve me 28 shtator 2023, kërkesën e kam shkruar në dy gjuhët dhe tanë pres ndihmën e juaj që të më këshilloni se ku duhet dorëzuar kërkesën.

**Klaudia Mula**, duke iu përgjigjur znj. Behluli tha se kërkesën duhet ta paraqitni në Drejtorin e Kulturës, ashtu siç e potencoi edhe udhëheqësja e asaj drejtorie, ndërsa sa i përket lobimit, përkrahjes nëpër drejtori, përkrahjen tonë do të keni gjithmonë.

Pas disa diskutimesh, sugjerimesh, propozimesh, Komiteti për Komunitete nxori këto

#### **R E K O M A N D I M E:**

- Komunitetet jo shumicë kërkojnë nga organet kompetente të Komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera publike respektimin e përqindjes së përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë dhe mundësinë e punësimit, qoftë edhe me kontratë mbi vepër;
- Përfaqësuesit e komunitetit jo shumicë kërkojnë që ZKKK-së, të informoj Komitetin për Komunitete për shpalljen e konkurseve, vendet e lira të punës;
- Të ftohet udhëheqësi i Zyrës së personelit z. Fadil Aliu;
- Të ftohet drejtorja e Drejtorisë së Arsimit znj. Besianë Musmurati.

*Mbledhja mbaroi në ora 11 :10*

Procesmbajtësja  
Lendita Spahija

Kryesuesja e komitetit  
Dr. Mirsada Behluli



Faqe 5 nga 5